

## Aplikim për vizë punësimi në sektorin e kujdesit infermieror në Gjermani

*(Ndhmës infermier, Infermierë si edhe personel përkujdesjeje për moshat e treta si edhe për ata që janë në proces njohjeje)*

Ju lutemi lexojeni me kujdes këtë fletë informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni kërkesave të përshkruara aty.

Formular të plotësuar pjesërisht ose dokumentacione të paplota mund të çojnë në kthim të aplikimit. Një regjistrim i ri për takim ka kohë të gjatë pritje.

Gjatë procesit të aplikimit të vizës ambasada duhet të përfshijë në vendimmarrje edhe autoritetet përkatëse në Gjermani. Procesi si rregull zgjat 2-4 jave, në raste qëndrimesh të mëparshme në Republikën Federale zgjat edhe me shume. Ju lutemi të keni mirësinë që pyetje rreth gjendjes aktuale të aplikimit, nuk mund tu përgjigjemi brenda 5 javëve të para, duke filluar nga momenti i aplikimit.

### Për aplikim ju nevojiten dokumentat e mëposhtëm ashtu si janë përshkruar

1.	<b>Formular aplikimi për vizë kombëtare</b>	Në gjermanisht ose anglisht, <b>2 copë</b> të plotësuar tërësisht dhe me shkrim të lexueshëm, të nënshkruar nga aplikuesi.
2.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të <b>paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
3.	<b>Fotografi</b>	<b>3 fotografi identike biometrike</b> , jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhesia 45 X 35 milimeter Ju lutemi të ngjisni dy fotografi në formularët e aplikimit dhe fotografinë e tretë sillini shtesë me vete.
4.	<b>Deklaratë që përshkruan punën që do të kryeni</b>	Deklaratën e gjeni <a href="#">këtu</a> . Kjo deklaratë është e detyrueshme që prej 1 prill 2020 për të gjitha fushat e punësimit, edhe për kualifikim (shkollë profesionale).
5.	<b>Në rast se kërkohet: dëshmi të siguracionit të pensionit</b>	Aplikuesit, duke filluar nga 45 vjeç, duhet të kenë një pagesë mujore prej të paktën 3.795,- Euro bruto (e vlefshme për vitin 2020) ose dëshmi të siguracionit të pensionit.

### Për secilën kategori kërkohen dokumentat e mëposhtme shtese si

#### Ndhmës infermier

Dokumentat e mëposhtëm duhet të dorëzohen ne momentin e aplikimit në origjinal edhe dy kopje

6.	<b>Kontratë pune ORIGINALE ose Oferte për vend pune</b>	Te nënshkruara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi duke u percaktuar profesioni <b>Ndhmes infermier, Paga bruto, orët e punës/ javë</b> dhe <b>fillimi</b> më i afërt i punësimit të planifikuar.
7.	<b>Certifikatë e njohur për nivelin e gjermanishtes</b>	Njohuri të gjuhës gjermane <b>Niveli A 2</b> Certifikatë e njohur sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).

OSE

**Infermier ose personel përkujdesjeje për moshat e treta**  
**Dokumentat e mëposhtëm duhet të dorëzohen ne momentin e aplikimit në original edhe dy kopje**

6.	<b>Kontratë pune ORIGINALE ose Oferte për vend pune</b>	Te nënshkruara nga punëdhënësi dhe punëmarrësi duke u përcaktuar profesioni , <b>Paga bruto, orët e punës/ javë dhe fillimi</b> më i afërt i punësimit të planifikuar.
7.	<b>Certifikatë e njohur për nivelin e gjermanishtes</b>	Njohuri të gjuhës gjermane <b>Niveli B 2</b> Certifikatë e njohur sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).
8.	<b>Leja për ushtrimin e profesionit</b>	Pergjithesisht është një <b>certifikate gjermane</b> për lejen e ushtrimit të profesionit "Infermier"

**OSE**

**Pjesmarrje në zhvillimin e orëve praktike/teorike për arritjen e njohjes së diplomës tuaj në Gjermani**  
**Dokumentat e mëposhtëm duhet të paraqiten në original si edhe në dy kopje në momentin e aplikimit**

6.	<b>Kontrata ORIGINALE</b>	për periudhen e praktikës dhe për punësimit e planifikuar pas përfundimit me sukses të praktikës. E nënshkruar nga punëdhënësi dhe punëmarrësi, duke u përcaktuar <b>pagesa mujore bruto, koha javore e punës dhe fillimi</b> i planifikuar i periudhes se praktikës dhe i punësimit.
7.	<b>Vërtetim</b>	i autoriteteve përkatëse gjermane, për orët praktike/ teorike që mungojnë, me qëllim që të arrihet njohja e diplomës në Gjermani.
8.	<b>Certifikatë e njohur për nivelin e gjermanishtes</b>	Njohuri të gjuhës gjermane <b>Niveli B1</b> Certifikatë e njohur sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian për Referencat e Gjuhëve (KPERGJ).
9.	<b>Plan i detajuar i programit te formimit profesional</b>	Plan i cili duhet të përmbajë mënyrën se si do të balancohen orët praktike dhe teorike të munguara duke specifikuar datën e fillimit dhe të përfundimit të këtij procesi

Dokumenta shtesë, të cilat nuk specifikohen këtu mund të kërkohen më vonë, në çdo rast gjatë aplikimit për vizë ose ne vijim të procesit nga ana e ambasades. Aplikimi për vizë si ndihmës infermier mund të bëhet vetëm nga shtetas të ballkanit perëndimor.

Informacione të mëtejshme në lidhje me certifikatat e njohura të gjermanishtes i gjeni në fletën e informacionit „Dëshmi për njohuri gjuhësore në rast aplikimi për vizë“.

Pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit në Gjermani, viza ju lëshohet me një kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj. Ju lutemi të udhëtoni në kohën e duhur në Gjermani dhe drejtohuni atje te autoritetet përkatëse, të cilat merren me zgjatjen e lejes së qëndrimit dhe që janë autoritetet përkatëse kompetente për të gjitha çështjet tuaja ligjore si të huaj.

**Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

**Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tij.**